



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 23 të Rregullores së Punës së KQZ-së, si dhe duke u bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 27.08.2019, Nr.819/2019, për shpalljen e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 27.08.2019, nxjerr këtë:

VENDIM

Për zgjatjen e orarit të punës për stafin e SKQZ-së

- I. Miratohet zgjatja e orarit për ditët e punës, për stafin e Sekretariatit të KQZ-së, duke filluar nga ora 08:00 deri në ora 18:00.
- II. Orari i punës për ditën e shtune dhe të diele do të jetë nga ora 8:00 deri në ora 16:00.
- III. Përveç obligimeve nga pika I dhe II e këtij vendimi, stafi i SKQZ-së obligohet të jetë prezent në punë, gjatë mbledhjeve të KQZ-së, Këshillave dhe aktiviteteve tjera.
- IV. Obligohen departamentet/divizionet që përveç pikën I dhe II të këtij vendimi, bazuar në fazat dhe angazhimet sipas afateve ligjore të parapara, të qëndrojnë në vendin e punës deri në përfundimin e aktiviteteve.
- V. Obligohet personeli i KQZ/SKQZ-së që ditën e zgjedhjeve me datën 06 tetor 2019 të jenë prezent në vendin e punës, deri në përfundimin e aktiviteteve të parapara me planin operacional të ditës së zgjedhjeve.
- VI. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së për ndërmarrjen e procedurave administrative, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim, hyn në fuqi me datën 27.08.2019.

Arsyetim

Duke u bazuar në vendimin e presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 27.08.2019 për shpalljen e zgjedhjeve, zgjatja e orarit të punës bëhet për shkak të rritjes së nivelit të aktiviteteve, afateve të ngjeshura me angazhim shtesë deri në përfundim të aktivitetit të paraparë me planin Operacioal, dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Rregullat Zgjedhore të KQZ-së, Rregulloren e Punës të KQZ-së, Rregulloren nr.01/2013, për Organizimin e Sekretariatit të KQZ-së dhe Plani

Operacional lidhur me përgatitjet për zgjedhjet e parakohshme, që do të mbahen më datën 06 tetor 2019. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 27.08.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Valdete Daka

